# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-473556**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dibranët kthejnë Xibrën në landfill plehrash |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394446.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 11:24:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 11:13:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 11:12:00 UTC → 27 shtator 2026, 11:14:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `741e979233c759afcc5272bb947f83a5f84b588cb56aa97493131ae16992f2ea` |
| TEKSTI | `346b9b8087b69a374d59b46ac0e3f47036fce7902f9be940d5f0cd47859dbe95` |
| PAMJA | `b84a219060d03f3676b86c0fc0bc968232310937fcde6ec82d9105ba7a7afdbf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7bd2d03299e995125e2fcd7af1952240fb27cba4a03830289341e1dea6fb6336` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdfe5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7bd2d03299e995125e2fcd7af1952240fb27cba4a03830289341e1dea6fb6336`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dibranët kthejnë Xibrën në landfill plehrash

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 27.09.2026, 13:13

Share Share



Festa ka mbaruar prej tre javësh, por gjurmët e saj në Xibër të Dibrës vazhdojnë të qëndrojnë aty, vetëm se jo në formën e kujtimeve të bukura.

Një qytetar që ka kaluar sot në zonë ka denoncuar përmes pamjeve gjendjen skandaloze që është lënë pas: shishe, qese, ambalazhe dhe mbetje të shpërndara kudo, duke e kthyer një hapësirë natyrore në një landfill të improvizuar.

Njerëzit u mblodhën, festuan dhe u larguan. Plehrat, ndërkohë, mbetën. Dhe jo për një ditë apo dy, por për javë të tëra.

Aq mjafton për të treguar se për disa, festa përfundon sapo mbyllet muzika, ndërsa përgjegjësia për pastrimin duket se nuk ekziston fare.

Është e papranueshme që një zonë natyrore të lihet në këtë gjendje, sikur të ishte tokë pa zot. Natyra nuk është vendi ku hidhen mbeturinat pasi mbaron festa.

Xibra është kthyer në një pamje që nuk ka asgjë festive: nga vend ku njerëzit shkuan për t'u argëtuar, në një landfill në mes të natyrës.

Kush e organizoi aktivitetin dhe kush kishte përgjegjësinë për pastrimin duhet të japë llogari. Sepse një festë mund të zgjasë disa orë, por pasojat e papërgjegjshmërisë mund të qëndrojnë aty për muaj e vite.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.